



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri: KSC-BC-2020-06

Vendosi: Gjykatësi i procedurës paraprake
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Pjesëmarrës parashtrues: Prokurori i Specializuar

Data: 23 qershor 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*

Vendim mbi kërkesën urgjente të Prokurorit të Specializuar

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të nenit 39(3) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”), lëshon vendimin e mëposhtëm.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 24 prill 2020, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) paraqiti një aktakuzë konfidenciale dhe *ex parte* për konfirmim (“Aktakuza”) së bashku me material provues në mbështetje të fakteve mbi të cilat bazohen akuzat dhe një përmbledhje të detajuar që demonstroi lidhjen e çdo prove me secilën akuzë.²

2. Më 23 qershor 2020, ZPS-ja parashtrroi një kërkesë urgjente për autorizim për nxjerrje informacioni në lidhje me Aktakuzën (“Kërkesa”).³

II. PARASHTRIME

3. Në kërkesë, ZPS-ja parashtron se veç përpjekjeve të raportuara më herët për ndërhyrje ndaj hetimeve të ZPS-së dhe administrimit të duhur të drejtësisë,⁴ ekzistojnë rreziqe të rënda dhe të menjëhershme ndaj hetimeve, ndjekjeve penale dhe proceseve prej një fushate që ende vazhdon prej dy të dyshuarve të identifikuar në Aktakuzë, Hashim Thaçi (“z. Thaçi”) dhe Kadri Veseli (“z. Veseli”), për pengimin dhe sabotimin e mandatit të Dhomave të Specializuara (“DHS”) dhe ZPS-së.⁵ ZPS-ja parashtron se në përgjigje të këtyre rreziqeve ndaj administrimit të drejtësisë, ndër të tjera, ndërhyrjes së mundshme ndaj dëshmitarëve dhe viktimave, është e domosdoshme të

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për caktimin e gjykatësit të procedurës paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-06, F00002, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës për konfirmim*, 24 prill 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me shtojcat 1-3, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

³ KSC-BC-2020-06, F00008, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë urgjente për autorizim për nxjerrje informacioni në lidhje me Aktakuzën*, 23 qershor 2020, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

⁴ KSC-BC-2020-06, F00005, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë për fletarrestime dhe urdhra në lidhje me to*, 28 maj 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para 7-26.

⁵ Kërkesa, para. 2.

nxirret publikisht dhe pa vonesë informacion i kufizuar nga Aktakuza që identifikon z. Thaçi dhe z. Veseli si të dyshuar kundër të cilëve janë ngritur akuza dhe përshkruan përgjithësisht natyrën e akuzave kundër tyre.⁶ Gjithashtu, ZPS-ja bën të ditur se në nxjerrjen e këtij informacioni do të qartësojë se Aktakuza është thjesht padi penale dhe po shqyrtohet prej gjykatësit të procedurës paraprake i cili do të vendosë përfundimisht nëse do t'i konfirmojë akuzat.⁷

4. Rrjedhimisht, ZPS-ja kërkon autorizim nga gjykatësi i procedurës paraprake për nxjerrjen publike të informacionit të mëposhtëm nga Aktakuza: (i) identitetet e z. Thaçi dhe z. Veseli si të dyshuar kundër të cilëve janë ngritur akuza; dhe (ii) numrin e akuzave, cilësimin juridik dhe natyrën e krimeve të pretenduara, numrin e përafërt të viktimave të identifikuar dhe përkatësinë ose prejardhjen e tyre etnike.⁸

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

5. Neni 39(3) i Ligjit përcakton se me kërkesë të Prokurorit të Specializuar gjykatësi i procedurës paraprake mund të nxjerrë urdhra që gjykohen të nevojshëm për kryerjen e hetimit dhe përgatitjen e një gjykimi të drejtë dhe të shpejtë.

6. Rregulla 86(2) e Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja") përcakton se Prokurori i Specializuar ia paraqet aktakuzën në mënyrë konfidenciale dhe *ex parte* gjykatësit të procedurës paraprake për vendim bazuar në nenin 39(2) të Ligjit.

⁶ Kërkesa, para. 2.

⁷ Kërkesa, para. 2.

⁸ Kërkesa, para. 4.

